



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:070304

Datë: 09.11.2021

Numri i dokumentit: 02451397

P.1661/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.U., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2510-6/2018, e dt.12.12.2018, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datë 03.11.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesit të palës së dëmtuar Liridon Jetishi dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 09.11.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri V.U., nga i ati B., e ëma M., e gjinisë N., i lindur me dt...., në fshatin ... K. Ferizaj ku dhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar baba i një fëmije, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, i dënuar edhe më parë për vepër të ngjashme penale, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë 13.11.2018, rreth orës 22.30, në vendin e quajtur “...” në regjionin ekonomik pyjor Neredime - Jezerc K. Ferizaj, me qëllim të vjedhjes në pyllin e pronësisë shoqërore, me sharrë motorike ka prerë një (1) trung druri të llojit ahu, me diametër 84cm, pa gjatësi të caktuar, me vëllim të përgjithshëm prej 6.69 metër kub, dru të cilat i ka transportuar me traktor të markës “ Fend ”, duke i shkaktuar kështu dëm Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari të komunës së Ferizajt, në vlerë prej 903,15 Euro.

me këtë ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 2, 4, 7, 8, 17, 21, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 70, 73 dhe neni 358 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 365, 453, 463, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të pandehurit e,

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 euro, (dyqind euro). Dënimi me burg ndaj të pandehurit nuk do të ekzekutohet, nëse të pandehuri brenda afatit prej 1 /një/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale (koha e verifikimit), në të kundërtën dënimi i tillë do të revokohet, ndërsa dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se e pandehurit nuk i paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas neni 46 par. 3 të KPK-së, i njëjtit dënim do t'i shëndrrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 Euro (njëzet euro), si dhe në emër kompensimin të Viktimave të Krimit shumë prej 30 € /tridhjetë euro/, që të dyja shumat brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

I pandehuri obligohen që të dëmtuarës - Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari të komunës së Ferizajt, t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në shumë prej 903,15 € (nëntëqind e tri euro e pesëmbëdhjetë cent), brenda afatit prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.2510-6/2018, e dt.12.12.2018, ka ngarkuar të pandehurin për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar publik me datë 03.11.2021, në të cilën prokurori shtetit, lexoj aktin akuzues dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 246 par. 4 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas të gjitha pikave të saj, duke shtuar se ndihem i penduar, jam i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë, **jam në** gjendje të rëndë ekonomike dhe për këtë kam qenë i detyruar të shkoj në pyll të marrë dru pa leje për ti siguruar ato për nevoja të mija familjare dhe premtoj që në të ardhmen nuk do të përsërisë kësso vepra penale pasi që edhe me shëndet nuk jam mirë dhe lus gjykatën që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh këtë që e thash dhe të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur .

Prokurori i shtetit me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me që i njëjti pranim është i bazuar me gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i njëjti e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së, si dhe në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës, ndërsa gjatë matjes së dënimit të merret parasysh pranimi i fajësisë dhe të njëjtit ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Përfaqësuesi i DBP-Ferizaj: Liridon Jetishi lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit ka deklaruar se: e mbështesë në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe paraqes kërkesë pasurore –juridike.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit si: fletëparaqitja e rojës së pyjeve me numër të ditarit 72/2018 e datës 26.11.2018, procesverbali i komisionit të ekspertëve me numër të protokollit nr.504/2018 e datës 26.11.2018, raporti i pylltarit i dt. 26.11.2018, deklaratata e të pandehurit e dhënë në polici me dt. 14.11.2018, si dhe shkesat tjera që gjenden në lëndë

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 par. 2 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së veprës penale për çka dhe i

pandehuri u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënimi siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese përkatësisht që në shqyrtimin fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej kësi lloj vepre penale, gjendjen e dobët ekonomike të tij, ndërsa në rastin konkret si rrethana rënduese gjeti se i pandehuri edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale vjedhje pylli, me aktgjykime të plotfuqishme P.nr.1945/17 i plotfuqishëm me dt.21.3.2019, me dënim me kusht, me aktgjykim P. nr.2654/17, i plotfuqishëm 31.10.2018, me dënim me gjobë dhe me aktgjykimin P.nr.2311/17, i plotfuqishëm me dt. 30.8.2019, me vrejtëje gjyqësore, po ashtu gjykata vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për obligimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar të dëmtuarës është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
P.1661/18, e datës 09.11.2021

Zyrtare Ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.